



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2019:143615
Datë: 22.10.2024
Numri i dokumentit: 06332187

C.nr.189/2019

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, sipas gjyqtarit Alush Sinani, çështjen juridike civile kontestimore të paditëses Byroja e Sigurimeve e Sigurimeve “BKS”, me seli në Prishtinë, Rr. ”Lidhja e Pejës” pn. Të cilën e përfaqëson B.C.Zyrtare ligjore në departamentin ligjor, administratë dhe trajnime te paditësja, kundër të paditurit, R.A., nga fshati P., Komuna e Vitisë, me bazë juridike rimbursimi i dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit 9,535.00 euro, duke vendosur për propozimin e përfaqësuesit të paditësit, për kthim në gjendjen e mëparshme, jashtë seancës gjyqësore, me datën 05.06.2023, bie këtë:

A K T V E N D I

REFUZOHET propozimi për kthim në gjendjen e mëparshme, e përfaqësuesit të paditëses Byroja e Sigurimeve e Sigurimeve “BKS”, me seli në Prishtinë, Rr. ”Lidhja e Pejës” pn. Të cilën e përfaqëson B.C.Zyrtare ligjore në departamentin ligjor, administratë dhe trajnime te paditësja, kundër të paditurit, R.A., nga fshati P., Komuna e Vitisë, me bazë juridike rimbursimi i dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit 9,535.00 euro, **si i pa bazuar**.

A r s y e t i m

Paditësi Byroja e Sigurimeve e Sigurimeve “BKS”, me seli në Prishtinë, Rr. ”Lidhja e Pejës” pn. Të cilën e përfaqëson B.C.Zyrtare ligjore në departamentin ligjor, administratë dhe trajnime te paditësja, me datën 16.08.2024, i ka parqitur kësaj gjykate propozimin për kthimin në gjendje e mëparshme, për shkak se paditësja, nuk kishte marrë pjesë në seancën gjyqësore të mbajtur me datë 09.08.2024, me arsyetimin se ditën e seancës, ka pasë shqetësime shëndetësore dhe është ndalur në shtëpinë e shendetit. Gjykata me aktvendim e C nr 182/2019 të datës 12.08.2024, e kishte konsideruar të tërhequr padinë e paditëses Byroja e Sigurimeve e Sigurimeve “BKS”, me seli në Prishtinë, kurse aktvendimin e veçantë paditësja e kishte pranuar me datë 16.08.2024, dhe e paknaqur me këtë aktvendim paditësja përmes përfaqësueses saj, me datë 16.08.2024, ka ushtruar kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme.

Pas vlerësimit të parashtrësës, gjykata ka ardhur në përfundim se propozimi nuk është i bazuar.

Sipas nenit 129.1 të LPK-së “Ne qoftë se pala nuk shkon në seancë fare apo e humbë afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humbë të drejtën që më vonë të kryejë veprimin procedural të lidhur me afat, gjykata do t’i lejojë kësaj pale, me propozimin e saj, ta kryejë më vonë këtë veprim, po që se e konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen”. Sipas procesverbalit të datës 01.08.2024, padit[s]ja kishte qenë e njoftuar në mënyrë të rregullt për seancën gjyqësore të datës 09.08.2024, me fillim në ora 13:15/h, mirpo paditësja kishte munguar dhe me asnjë shkresë apo në mënyrë tjetër komunikimi, gjykatën nuk e ka njoftuar, kështu që gjykata ka kobstatuar se paditësja ka pasur njohuri dhe obligim të paraqitet në gjykatë, apo gjykatën ta lajmëroj së paku përmes ndonjë parashtrësë apo në formë elektronike, gjë të cilën para seancës nuk e ka bërë. Prandaj, gjykata bazuar në faktet e më sipërme konsideron se pala paditëse e ka pasur të njohur datën dhe kohën e mbajtjes së seancës gjyqësore si dhe pasojën e mosparaqitjes në seancë, andaj paraprakisht ka qenë dashur të ketë në konsideratë edhe pasojat e mungesës së paarsyeshme në seancë, apo mos arsyetimin me kohë të mungesës së saj në seancën kryesore.

Për këtë arsye, Gjykata ka vlerësuar se në këtë rast nuk ekzistojnë shkaqe të arsyeshme sepse, përfaqësuesi i paditësit, nga data 01.08.2024 ka qenë i njoftuar për seancën e datës 09.08.2024 dhe përkundër kësaj, nuk e ka ndërmarrë asnjë veprim për të evituar pasojat që do të shkaktoheshin më rastin e mungesës.

Nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 129 LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:143615, 22.10.2024
C. nr. 182/2019**

Gjyqtari,
Alush Sinani

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.